




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-0/D2K	Prot. No. 01-932/15
Nr. l faq.	Data
Broj stranica 02	Datum 27-03-2015
Nr. pages	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	27.03.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Burim GURI Zyrtar i Prokurimit në Organin Shqyrtues të Prokurimit
CC:	z. Hysni HOXHA Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull "Shërbime të përkthimeve nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Serbo – Kroate apo anasjelltas për nevojat e OSHP-së"



I nderuari z. Guri ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin **"Shërbime të përkthimeve nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Serbo-Kroate apo anasjelltas për nevojat e OSHP-së"** me numër prokurimi: 240 15 006 221 Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin **"Shërbime të përkthimeve nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Serbo – Kroate apo anasjelltas për nevojat e**

OSHP-së" me numër prokurimi: 240 15 006 221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Organi Shqyrtues i Prokurimit si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës për Prokurim ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull *"Shërbime të përkthimeve nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Serbo – Kroate apo anasjelltas për nevojat e OSHP-së"* me numër prokurimi: 240 15 006 221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.12.03.2015 në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 12.03.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknike dhe profesionale 1. **Kërkohet lista me dy kontrata dhe të bashkangjiten dy referenca listës së kontratave të ngjashme me shërbimet e realizuar në 3 vitet e fundit 2012/13/14, duke përfshirë vitin 2015** kërkesa këto të cilat konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas LPP-së, një Autoritet kontraktues mundet të kërkoj dëshmi me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, atëherë kërkesat duhet t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet në asnjë mënyrë të kalojë këtë kufizim prej tri viteve të fundit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 69 Aftësitë Teknike dhe /ose Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së .

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !